

VENDIM

Nr.179, dt. 25.09.2015

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e dates 25.09.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të HEC-eve që do të zhvillohen në Kaskadën e Lumit Rajan, Komuna Barmash dhe Leskovik, rrethi Kolonjë, Qarku Korçë, (Hec Arrëz, Hec Shëndelli , Hec Sotirë, Hec Mesare, Hec Podë, Hec Rajan 2, Hec Peshtan, Hec Osnat, Hec Radon, Hec Gradisht, Hec Dedovë).
2. Ngarkohet shoqëria të bashkëpunojë me Institutin e Monumenteve të Kulturës për të kontribuar në restaurimin e Kishës së Shën Marisë, Barmash, Rrethi Kolonjë, sipas projektit të hartuar nga IMK.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI


